

V E N D I M
Nr.164, datë 19.4.1994

PËR TRAJTIMIN EKONOMIK TË TË VERBËRVE

Me prozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, duke u mbështetur në ligjin nr.771O, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Gjithë personat lindur të verbër, ose që kanë humbur shikimin para moshës 18 vjeç, të vërtetuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) pranë Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, me gjëndje shëndetësore të invaliditetit të grupit të parë e të dytë sipas kritereve për përcaktimin e aftësisë për punë të invalidëve të vitit 1991, marrin përfitim paaftësie, nëse plotësojnë kushtet e parashikuara në ligjin e sipërpërmendur.

2. Përfitimi i paaftësisë është i barabartë në vlerë me ndihmën ekonomike për familjet me një anëtar.

3. Gjithë të verbërit sipas pikës 1 të këtij vendimi që kanë humbur vendin e punës pas janarit 1991 dhe që nuk përfitojnë pension invaliditeti në bazë të ligjit nr.77O3, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, marrin përfitim paaftësie 150 për qind të vlerës të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

Kjo është e vlefshme për sa kohë nuk janë në marrëdhënie pune.

4. Përfitimi i paaftësisë konsiderohet si e ardhur personale dhe si e tillë nuk llogaritet në të ardhurat e familjes që përfiton ndihmë ekonomike në bazë të ligjit nr.771O, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”.

5. Gjer më 1 korrik 1994 pagesa e përfitimit të paaftësisë për të verbërit do të bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Shpenzimet do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi